



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 11

Tiranë – E enjte, 5 shkurt 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 21.1.2015	Për trajtimin e disa familjeve, që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”, me programe sociale të strehimit..... 359
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 28.1.2015	Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë, të një pjese të pasurisë “Oficina e automjeteve, Tiranë”, zona kadastrale nr. 8250, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Punëve të Jashtme..... 360
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 28.1.2015	Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2016 – 2018..... 363
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 70, datë 28.1.2015	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, të pronës nr. 598, me emërtim “Qendër mobilizimi”, me vendndodhje në Gjirokastër, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 366
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 72, datë 28.1.2015	Për shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Zonë e lirë”, në Spitallë, Durrës, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 391, datë 21.2.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen “Zonë ekonomike”, në Spitallë, Durrës”..... 369
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 28.1.2015	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Primavera industry” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Sallë prodhimi në katin përdhes në “Prodhim veshje” sh.a., Durrës”..... 371
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 74, datë 28.1.2015	Për ndryshimin, nga tokë bujqësore “Arë” në tokë urbane, “Truall”, të sipërfaqes prej 15 000 m ² , në zonat kadastrale nr. 2119 dhe nr. 2105, Kashar, Tiranë..... 372

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 28.1.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 267, datë 21.4.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për bashkërendimin e punës së ALUIZNI-t me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”.....	373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 28.1.2015	Për zbatimin e ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”.....	373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 28.1.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i Amfiteatrit të Durrësit”.....	375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 28.1.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 241, datë 31.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për kryerjen, nga “Posta shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”.....	376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 28.1.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Don Gjon Buzuku”, Korçë”.....	377

**VENDIM****Nr. 58, datë 21.1.2015**

**PËR TRAJTIMIN E DISA FAMILJEVE,
QË PREKEN NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS
TRANSBALLKANIKE ME
SUPERSTRADËN FIER-VLORË”, ME
PROGRAME SOCIALE TË STREHIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Familjet, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, që posedojnë ndërtime pa leje, me funksion banimi, të cilat preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e Rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”, përfitojnë nga programi social i strehimit, pagesën e qirasë për një periudhë dyvjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit mbulon pagesën e qirasë për këto familje, nëpërmjet fondit të programit të strehimit, sipas vitit buxhetor përkatës.

Lidhja nr. 1

NR.	EMËR, ATËSI, MBIEMËR
1	MYSLYM SHEFQET LAMAJ
2	AGIM SHEFQET MUCAJ
3	HALO SHUAIP KAMBERAJ
4	EDMOND SEIT BREGU
5	ARBEN HAXHI LULE
6	GEZIM BEGO BEGAJ
7	ZENEL QAMIL QAMILI
8	ASTRIT LAVDOSHI HITAJ
9	ALBERT HAJRI HITAJ
10	RUZHDI ISLAM SHUAIP
11	XHAHER ISMAIL SHUAIP
12	IZET ISMAIL SHUAIP
13	ARJAN ISA DRIZA
14	AGRON HAXHI LULE
15	GEZIM HAXHI LULE
16	PETREF QAZIM BRAKA
17	FATMIR QAZIM DRIZA
18	ALFRED FLAMUR LULE
19	FLAMUR HAXHI LULE
20	EMIN SAFET SHEHU
21	REMZI FAIK KASAJ
22	KASTRIT KADRI BEJA
23	ILIR ISUF SHULLA
24	KAJMAK MIFTAR LAMAJ
25	NIKO SHEME DHAMO
26	NOVRUZ BARJAM Tafa
27	HAKI LUTO HAXHIRAJ

3. Enti Kombëtar i Banesave, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përcakton vlerën e qirasë mujore, e cila miratohet nga ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

4. Për llogaritjen e vlerës së qirasë mujore, që përfiton çdo familje, Enti bazohet në:

a) normat e strehimit sipas vendimit nr. 814, datë 3.12.2004, të Këshillit të Ministrave, dhe strukturën e apartamentit që përfiton familja;

b) vlerën mesatare të qirasë së banesave në treg, të shprehur në lekë/m².

5. Vlera mesatare e qirasë së banesës, sipas shkronjës “b”, të pikës 4, t’i referohet së njëjtës zonë ose zonave të ngjashme, duke u bazuar në informacionin e marrë nga agjencitë imobiliare.

6. Familjet e përcaktuara në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, duhet të paraqesin pranë EKB-së certifikatë të gjendjes familjare.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

28	BESIM QEMAL XHEMAJ
29	ADEM VERO VERAJ
30	ELHAM HAXHI GJOLEKA
31	SAMIT DULE DURAJ
32	MECO FASLLI HYSAJ
33	FATMIR XHEVAIR TOSKA
34	FADIL RAMO DINE
35	RAMADAN SHABAN MOLISHTARI
36	FATOSH MEDIN RAMAJ
37	BASHKIM JONUS KASAJ
38	VALENTINA ETEM MUSAKU
39	SAMIT LATIF MUSAKU
40	BASHKIM MUCAJ
41	DILAVER HOXHA
42	PELLUMB BEGAJ
43	ARSEN QAMILI
44	PETRIT SHUAIP
45	LUAN SHUAIP
46	KOCO XHEMALI
47	SAMIT FEKA
48	PERPARIM NDESHAJ
49	HEKTOR SHORAJ
50	BILBIL LLOJI
51	RAMADAN AMETI
52	ARBEN HYSI
53	HODO IDAJET HAXHIRAJ

**VENDIM****Nr. 67, datë 28.1.2015**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA
SHPËRBLIM, AMBASADËS SË
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS,
NË TIRANË, TË NJË PJESE TË
PASURISË “OFIÇINA E AUTOMJETEVE,
TIRANË”, ZONA KADASTRALE NR.
8250, TIRANË, NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim, pa shpërblim, Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë, të një pjese të pasurisë “Ofiçina e automjeteve, Tiranë”, zona kadastrale nr. 8250, Tiranë, ndërtesë së bashku me truallin funksional

prej 9 000 m², sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, pasuri në administrim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për përdorimin e saj nga kjo ambasadë, në përputhje me termat e marrëveshjes së reciprocitetit, të nënshkruar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës.

2. Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë, i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për kryerjen dhe ndjekjen e procedurave ligjore të shpronësimit publik, të pronarëve të truallit që preken nga zbatimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe kryeregjistruesi i Zyrës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama




PLANVENDOSJE




Shk: 1:1000

ZK 8250

Indeksi Hartes: TR;Q-8
TR;R-8

9000 m²





Legjenda

— Kufiri Prones



VENDIM

Nr. 68, datë 28.1.2015

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT
MAKROEKONOMIK E FISKAL PËR
PERIU DHËN 2016 - 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2016 - 2018, sipas lidhjes nr. 1, “Treguesit kryesorë makroekonomikë”, dhe lidhjeve nr. 2/1 e nr. 2/2, “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

Lidhja nr. 1*Treguesit kryesorë makroekonomik*

Treguesit	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
							Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	3.0
Inflacioni (mesatar)	%	2.3	3.6	3.5	2.0	1.9	1.6	2.5	2.8	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	2.4	4.5	2.3	1.0	0.8	1.4	2.5	2.8	3.0	3.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	95.0	103.9	100.9	108.2	105.7	105.2	119.5	119.5	119.5	119.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	131.6	137.7	140.5	139.0	140.3	139.9	141.0	141.0	141.0	141.0
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)	Lek / USD	41.7	44.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5
Rritja reale e PBB	%	3.4	3.7	2.5	1.6	1.4	2.1	3.0	4.0	4.5	4.5
PBB	Lek miliardë	1,143.9	1,239.6	1,300.6	1,335.5	1,364.8	1,413.9	1,492.0	1,596.0	1,717.9	1,848.9
PBB	USD miliardë	12.0	11.9	12.9	12.3	12.9	13.4	12.5	13.4	14.4	15.5
PBB	Euro miliard	8.7	9.0	9.3	9.6	9.7	10.1	10.6	11.3	12.2	13.1
PBB për banor	Lek mijë	389.6	424.7	447.4	460.2	470.8	488.2	512.6	545.6	584.4	625.8
PBB për banor	USD	4,101.3	4,086.7	4,433.6	4,253.5	4,454.9	4,642.3	4,289.8	4,566.0	4,890.5	5,237.0
PBB për banor	Euro	2,960.4	3,084.6	3,183.7	3,311.0	3,356.5	3,490.4	3,635.7	3,869.7	4,144.7	4,438.4
PBB për banor	USD-PPP	9,331.2	9,552.6	9,841.4	10,123.2	10,357.4	10,740.9	11,277.5	12,003.4	12,856.5	13,767.4
Norma e papunësisë	%	13.8	14.2	14.3	14.1	17.1	17.3	16.4	15.3	13.9	12.4
Të ardhurat totale	% të PBB	26.1	26.2	25.4	24.7	24.0	26.0	27.8	27.8	27.9	27.9
Shpenzimet totale	% të PBB	33.2	29.3	28.9	28.2	28.9	32.3	31.7	30.3	29.2	28.5
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-7.1	-3.1	-3.5	-3.4	-4.9	-6.3	-3.9	-2.6	-1.3	-1.0
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-3.9	0.3	-0.4	-0.3	-1.7	-3.4	-0.6	0.6	1.7	2.0
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	1.3	2.4	1.9	1.2	-0.1	0.9	2.0	3.0	4.0	4.6
Huamarrje totale neto	% të PBB	4.6	3.1	3.5	3.5	4.1	6.2	3.8	2.6	1.3	1.0
Borxhi Publik Total	% të PBB	59.7	57.7	59.4	62.1	70.1	72.0	71.8	68.9	65.7	62.1
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% të PBB	55.7	54.0	55.7	58.1	61.1	65.2	65.6	63.8	60.6	57.3
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	% të PBB	4.0	3.7	3.7	4.0	9.0	6.9	6.2	5.1	5.1	4.8
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-15.3	-11.3	-13.2	-10.2	-10.6	-11.9	-11.8	-12.4	-12.5	-12.3
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-24.5	-20.6	-22.8	-18.6	-17.8	-18.3	-18.0	-18.0	-17.5	-16.7
Mallra	% të PBB	-26.5	-23.1	-24.2	-20.8	-17.7	-19.7	-20.2	-20.2	-19.8	-18.9
Eksporte	% të PBB	8.6	13.0	15.2	15.9	18.0	17.1	17.7	18.0	18.3	18.8
Importe	% të PBB	-35.1	-36.1	-39.4	-36.7	-35.7	-36.7	-37.9	-38.2	-38.1	-37.7
Bilanci i pagesave	% të PBB	-0.3	2.0	-0.3	0.8	1.1	2.2	2.1	2.1	2.2	1.9

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Boterore



Lidhja nr.2/1

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
në milion Lekë

							2014	2015	2016	2017	2018
Nr.	E M Ë R T I M I	2009	2010	2011	2012	2013	A.N.-Dhjetor 2014	Buxheti	PBA	PBA	PBA
TOTALI TË ARDHURAVE		298,981	324,721	330,469	330,384	327,178	367,949	414,469	443,124	478,970	515,054
I.	Ndihmat	4,430	4,605	3,811	5,559	5,737	8,500	12,000	12,800	13,800	14,000
nga të cilat: mbështetje buxhetore nga KE								2,000	2,000	2,000	2,000
II.	Të ardhura tatimore	270,830	288,564	303,927	300,862	299,888	336,838	377,069	408,087	441,827	476,354
II.1	Nga tatimet dhe doganat	208,870	223,019	235,509	232,591	229,031	260,517	294,717	319,745	346,736	374,014
1	Tatimi mbi vlerën e shituar	110,062	113,998	119,189	116,533	111,940	125,797	135,254	147,113	159,980	172,652
2	Tatimi mbi fitimin	17,149	17,606	19,712	16,853	15,119	21,904	23,547	25,517	27,571	29,727
3	Akcizat	33,504	38,788	40,403	36,421	38,151	44,520	51,704	56,858	61,774	66,606
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	26,820	27,058	27,967	27,989	29,570	28,202	35,317	37,955	40,971	44,176
5	Taksa nacionale dhe të tjera	13,405	18,295	21,388	28,677	28,454	34,154	42,740	45,718	49,351	53,211
6	Taksa doganore	7,929	7,274	6,850	6,118	5,797	5,940	6,156	6,584	7,088	7,643
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	12,149	11,898	11,791	10,859	10,825	12,773	13,563	14,508	15,617	16,807
1	Taksa lokale	8,154	7,684	7,279	6,210	6,396	7,231	8,066	8,628	9,287	9,995
2	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	1,509	1,896	1,942	2,506	2,454	4,042	4,017	4,297	4,625	4,978
3	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël	2,486	2,318	2,570	2,143	1,975	1,500	1,480	1,583	1,704	1,834
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	49,812	53,647	56,627	57,411	60,033	63,548	68,789	73,834	79,473	85,532
1	Sigurimi shoqëror	44,344	45,041	48,839	49,533	51,064	55,129	58,988	63,394	68,302	73,575
2	Sigurimi shëndetësor	5,467	6,432	6,152	6,590	7,410	8,319	8,801	9,440	10,171	10,957
3	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	0	2,174	1,636	1,288	1,559	100	1,000	1,000	1,000	1,000
III.	Të ardhura jo-tatimore	23,720	31,552	22,731	23,963	21,553	22,611	25,400	22,237	23,343	24,700
1	Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë	6,241	4,936	5,710	4,693	4,628	1,951	62	37	843	1,500
2	Të ardhura nga institucionet buxhetore	9,338	13,994	10,336	10,276	9,987	13,685	15,127	15,500	15,800	16,500
	Të ardhura nga sistemi i arsimit të lartë	0	0	0	0	0	3,500	3,800	4,200	4,500	4,700
	Të ardhura jo-tatimore të pushtetit vendor	0	0	0	0	0	2,500	2,600	2,700	2,800	2,800
3	Dividenti	374	735	1,060	426	943	600	811	800	800	800
4	Tarifat shërbimeve	4,183	2,977	3,510	3,772	3,133	2,900	3,400	3,400	3,400	3,400
5	Të tjera	3,584	8,910	2,115	4,797	2,862	3,475	6,000	2,500	2,500	2,500
	Shitja e H.Dajtit/Hidro Lana-Bregasit	0	4,060	0	2,000	0	0	0	0	0	0
	Shitja e licencave 3G	0	4,352	1,500	500	0	0	0	0	0	0
	Jashtë limitit	0	0	0	0	0	1,700	1,760	1,850	1,900	2,000
	Të tjera (të rastësishme)	0	498	615	2,297	0	0	0	0	0	0
TOTALI I SHPENZIMEVE		379,863	362,752	376,300	376,241	394,118	456,404	472,697	483,844	501,553	533,542
I.	Shpenzime Korrente	283,898	300,878	305,621	312,585	328,641	349,350	376,197	385,205	399,297	415,217
I.1	Personeli	62,359	65,762	67,446	69,437	70,716	73,205	76,189	76,800	77,520	78,100
1	Paga	53,272	56,951	58,398	60,144	61,087	61,368	64,269	64,500	65,020	65,400
2	Kontributi për sigurime shoqërore	9,087	8,811	9,048	9,293	9,629	10,037	10,620	10,800	11,000	11,200
3	Fondi i veçantë i pagave	0	0	0	0	0	800	1,300	1,500	1,500	1,500
4	Politika të reja pagash	0	0	0	0	0	1,000	0	0	0	0
I.2	Interesat	36,301	41,604	41,121	41,498	43,335	40,100	49,200	49,600	52,000	56,100
1	Të brendshme	31,408	35,583	34,253	34,005	35,890	31,700	37,150	37,300	39,100	42,100
2	Të huaja	4,893	6,021	6,868	7,492	7,445	8,400	12,050	12,300	12,900	14,000
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje, nga të cilat:	32,058	34,318	32,995	31,470	32,424	36,486	39,679	40,650	42,000	43,200
1	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)	0	0	0	0	0	32,086	35,119	35,800	37,100	38,200
2	Arsim i lartë	0	0	0	0	0	2,700	2,800	3,000	3,000	3,000
3	Të tjera jashtë limitit	0	0	0	0	0	1,700	1,760	1,850	1,900	2,000
I.4	Subvencionet	2,004	3,535	3,301	1,884	1,574	1,600	1,760	1,760	1,760	1,760
I.5	Shpenzime për fondet speciale	96,725	106,207	113,894	120,269	127,644	135,860	143,662	151,137	160,150	169,300
1	Sigurime shoqërore	73,744	79,316	85,265	89,860	95,598	100,550	106,048	111,993	119,259	127,000
2	Politika të reja pensionesh	0	0	0	0	0	32,910	1,200	1,300	1,400	1,400
3	Sigurime shëndetësore	22,980	25,141	26,974	28,828	30,147	1,000	35,014	36,444	38,091	39,500
4	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0	1,750	1,655	1,581	1,899	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
I.6	Buxheti lokal	33,583	30,764	28,119	27,333	29,787	37,199	41,207	40,658	40,867	41,557
1	Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	21,434	18,866	16,328	16,474	18,962	21,726	12,535	13,000	14,000	14,500
2	Grantet konkurrese/Fondi i Zhvillimit Rajonal	12,149	11,898	11,791	10,859	10,825	12,773	13,563	14,508	15,617	16,807
3	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	0	0	0	0	0	200	400	450	450	450
4	Buxheti lokal (të ardhurat nga transferimi i rentës)	0	0	0	0	0	2,500	2,600	2,700	2,800	2,800
5	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)	0	0	0	0	0	2,500	2,600	2,700	2,800	2,800
I.7	Transferat të tjera	20,867	18,688	18,745	20,694	23,161	24,900	24,500	24,600	25,000	25,200
1	Pagesa e papunësisë	868	982	876	984	800	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
2	Ndihma ekonomike	16,060	16,706	16,369	18,011	19,370	21,000	19,900	20,000	20,100	20,300
3	Kompensim për të përndjekurit politikë	2,200	1,000	1,500	1,699	2,991	1,800	2,000	2,000	2,300	2,300
4	Kompensim për energjinë elektrike	0	0	0	0	0	1,100	1,600	1,600	1,600	1,600
II.	Fondi rezervë	0	0	0	0	0	3,050	5,500	6,000	7,000	11,500
1	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave	0	0	0	0	0	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500
2	Fondi kontigjencë për ruajtjen e deficietit	0	0	0	0	0	1,550	4,000	4,500	5,500	10,000
III.	Shpenzime kapitale	95,881	67,492	70,679	61,656	65,477	66,004	68,000	72,138	91,256	102,825
1	Financimi i brendshëm	75,600	46,642	41,097	27,398	36,701	35,293	29,238	22,423	30,877	37,025
2	Financimi i brendshëm kontigjencë	0	0	0	0	0	0	8,715	19,971	25,000	25,000
3	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta	0	0	0	0	0	800	1,000	1,200	1,500	1,700
4	Financimi i huaj	20,281	20,850	27,982	34,257	28,776	29,911	37,762	39,800	38,900	39,100
IV.	Detyrimet e prapambetura	0	0	0	0	0	35,000	20,000	16,500	0	0
V.	Të tjera	85	-5,618	0	2,000	0	1,500	3,000	4,000	4,000	4,000
3	Huadhënie neto (sistemi energjitik, etj)	0	-5,618	0	2,000	0	1,500	3,000	4,000	4,000	4,000
VI.	Fond shpronësimit	0	0	0	0	0	1,500	0	0	0	0
DEFICITI		-80,883	-38,031	-45,831	-45,857	-66,940	-88,455	-58,228	-40,719	-22,584	-18,489
FINANCIMI DEFICITIT		80,883	38,031	45,831	45,857	66,940	88,455	58,228	40,719	22,584	18,489
I.	I brendshëm	70,701	13,155	26,073	26,495	56,129	50,644	41,374	23,283	23,384	19,289
1	Të ardhura nga privatizimi	25,138	411	438	1,221	16,703	400	1,500	0	0	0
3	Hua-marrje e brendshme (neto)	43,339	11,284	28,175	24,783	46,298	50,244	39,874	23,283	23,384	19,289
4	Të tjera	2,224	1,460	-2,539	490	-3,399	0	0	0	0	0
II.	I huaj	10,182	24,876	19,758	19,362	10,811	37,811	16,854	17,436	-800	-800
1	Hua afatgjatë (e marrë)	15,375	59,793	25,229	32,257	22,354	21,411	69,812	29,000	27,100	27,100
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës	567	-1,705	2,142	-2,226	1,231	0	0	0	0	0
3	Ripagesat	-5,760	-33,212	-7,613	-10,669	-12,774	-18,600	-66,958	-25,564	-27,900	-27,900
4	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	0	0	0	0	0	35,000	14,000	14,000	0	0
MEMO:											
Borxhi Publik Total (Stok)		682,546	715,521	772,735	828,268	956,583					



Lidhja nr. 2/2

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
në % të PBB

							2014	2015	2016	2017	2018
Nr.	E M Ë R T I M I	2009	2010	2011	2012	2013	A.N.-Dhjetor 2014	Buxheti	PBA	PBA	PBA
TOTALI TË ARDHURAVE		26.1	26.2	25.4	24.7	24.0	26.0	27.8	27.8	27.9	27.9
I.	Ndihmat	0.4	0.4	0.3	0.4	0.4	0.6	0.8	0.8	0.8	0.8
	nga të cilat: mbështetje buxhetore nga KE							0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Të ardhura tatimore	23.7	23.3	23.4	22.5	22.0	23.8	25.3	25.6	25.7	25.8
II.1	Nga tatimet dhe doganat	18.3	18.0	18.1	17.4	16.8	18.4	19.8	20.0	20.2	20.2
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	9.6	9.2	9.2	8.7	8.2	8.9	9.1	9.2	9.3	9.3
2	Tatimi mbi fitimin	1.5	1.4	1.5	1.3	1.1	1.5	1.6	1.6	1.6	1.6
3	Akcizat	2.9	3.1	3.1	2.7	2.8	3.1	3.5	3.6	3.6	3.6
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	2.3	2.2	2.2	2.1	2.2	2.0	2.4	2.4	2.4	2.4
5	Taksa nacionale dhe të tjera	1.2	1.5	1.6	2.1	2.1	2.4	2.9	2.9	2.9	2.9
6	Taksa doganore	0.7	0.6	0.5	0.5	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	1.1	1.0	0.9	0.8	0.8	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9
1	Taksa lokale	0.7	0.6	0.6	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
2	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	0.1	0.2	0.1	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3
3	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël	0.2	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	4.4	4.3	4.4	4.3	4.4	4.5	4.6	4.6	4.6	4.6
1	Sigurimi shoqëror	3.9	3.6	3.8	3.7	3.7	3.9	4.0	4.0	4.0	4.0
2	Sigurimi shëndetësor	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6
3	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.0	0.2	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Të ardhura jo-tatimore	2.1	2.5	1.7	1.8	1.6	1.6	1.7	1.4	1.4	1.3
1	Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë	0.5	0.4	0.4	0.4	0.3	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1
2	Të ardhura nga institucionet buxhetore	0.8	1.1	0.8	0.8	0.7	1.0	1.0	1.0	0.9	0.9
	Të ardhura nga sistemi i arsimit të lartë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.3	0.3	0.3	0.3
	Të ardhura jo-tatimore të pushtetit vendor	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
3	Dividenti	0.0	0.1	0.1	0.0	0.1	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0
4	Tarifat shërbimeve	0.4	0.2	0.3	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
5	Të tjera	0.3	0.7	0.2	0.4	0.2	0.2	0.4	0.2	0.1	0.1
	Shitja e H. Dajtit/Hidro Lana-Bregasit	0.0	0.3	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Shitja e licencave 3G	0.0	0.4	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Jashtë limitit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Të tjera (të rastësishme)	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI I SHPENZIMEVE		33.2	29.3	28.9	28.2	28.9	32.3	31.7	30.3	29.2	28.9
I.	Shpenzime Korrente	24.8	24.3	23.5	23.4	24.1	24.7	25.2	24.1	23.2	22.5
I.1	Personeli	5.5	5.3	5.2	5.2	5.2	5.2	5.1	4.8	4.5	4.2
1	Paga	4.7	4.6	4.5	4.5	4.5	4.3	4.3	4.0	3.8	3.5
2	Kontributi për sigurime shoqërore	0.8	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.6	0.6
3	Fondi i veçantë i pagave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
4	Politika të reja pagash	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
I.2	Interesat	3.2	3.4	3.2	3.1	3.2	2.8	3.3	3.1	3.0	3.0
1	Të brendshme	2.7	2.9	2.6	2.5	2.6	2.2	2.5	2.3	2.3	2.3
	Të huaja	0.4	0.5	0.5	0.6	0.5	0.6	0.8	0.8	0.8	0.8
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje, nga të cilat:	2.8	2.8	2.5	2.4	2.4	2.6	2.7	2.5	2.4	2.3
1	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.3	2.4	2.2	2.2	2.1
2	Arsim i lartë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
3	Të tjera jashtë limitit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.2	0.3	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	8.5	8.6	8.8	9.0	9.4	9.6	9.6	9.5	9.3	9.2
1	Sigurime shoqërore	6.4	6.4	6.6	6.7	7.0	7.1	7.1	7.0	6.9	6.9
2	Politika të reja pensionesh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.3	0.1	0.1	0.1	0.1
3	Sigurime shëndetësore	2.0	2.0	2.1	2.2	2.2	0.1	2.3	2.3	2.2	2.1
4	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.6	Buxheti lokal	2.9	2.5	2.2	2.0	2.2	2.6	2.8	2.5	2.4	2.2
1	Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	1.9	1.5	1.3	1.2	1.4	1.5	0.8	0.8	0.8	0.8
2	Grante konkurrese/Fondi i Zhvillimit Rajonal	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8	0.6	0.5	0.4
3	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	1.1	1.0	0.9	0.8	0.8	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9
4	Buxheti lokal (të ardhurat nga transferimi i rentës)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
5	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
I.7	Transferata të tjera	1.8	1.5	1.4	1.5	1.7	1.8	1.6	1.5	1.5	1.4
1	Pagesa e papunësisë	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Ndihma ekonomike	1.4	1.3	1.3	1.3	1.4	1.5	1.3	1.3	1.2	1.1
3	Kompensim për të përfaqësuar politikë	0.2	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
4	Kompensim për energjinë elektrike	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.4	0.4	0.4	0.6
1	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Fondi kontigjencë për ruajtjen e deficitit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.3	0.3	0.3	0.5
III.	Shpenzime kapitale	8.4	5.4	5.4	4.6	4.8	4.7	4.6	4.5	5.3	5.6
1	Financimi i brendshëm	6.6	3.8	3.2	2.1	2.7	2.5	2.0	1.4	1.8	2.0
2	Financimi i brendshëm kontigjencë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.5	1.2	0.0
3	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
4	Financimi i huaj	1.8	1.7	2.2	2.6	2.1	2.1	2.5	2.5	2.3	2.1
IV.	Detyrimet e prapambetura	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.5	1.3	1.0	0.0	0.0
V.	Të tjera	0.0	-0.5	0.0	0.1	0.0	0.1	0.2	0.3	0.2	0.2
3	Huadhënie neto (sistemi energjitik, etj)	0.0	-0.5	0.0	0.1	0.0	0.1	0.2	0.3	0.2	0.2
VI.	Fond shpronësimit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
DEFICITI		-7.1	-3.1	-3.5	-3.4	-4.9	-6.3	-3.9	-2.6	-1.3	-1.0
FINANCIMI DEFICITIT		7.1	3.1	3.5	3.4	4.9	6.3	3.9	2.6	1.3	1.0
I.	I brendshëm	6.2	1.1	2.0	2.0	4.1	3.6	2.8	1.5	1.4	1.0
1	Të ardhura nga privatizimi	2.2	0.0	0.0	0.1	1.2	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
3	Hua-marje e brendshme (neto)	3.8	0.9	2.2	1.9	3.4	3.6	2.7	1.5	1.4	1.0
4	Të tjera	0.2	0.1	-0.2	0.0	-0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
II.	I huaj	0.9	2.0	1.5	1.4	0.8	2.7	1.1	1.1	0.0	0.0
1	Hua afatgjatë (e marrë)	1.3	4.8	1.9	2.4	1.6	1.5	4.7	1.8	1.6	1.5
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës	0.0	-0.1	0.2	-0.2	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
3	Ripagesat	-0.5	-2.7	-0.6	-0.8	-0.9	-1.3	-4.5	-1.6	-1.6	-1.5
4	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.5	0.9	0.9	0.0	0.0
MEMO:											
Borxhi Publik Total (Stok)		59.7	57.7	59.4	62.0	70.1	72.0	71.8	68.9	65.7	62.1
I.	Borxhi publik nga buxheti (stok)	55.7	54.0	55.7	58.0	61.1	65.2	65.6	63.8	60.6	57.3
1	I brendshëm (stok)	35.8	32.4	33.1	34.0	36.7	39.0	39.6	38.5	37.1	35.5
2	I huaj (stok)	19.9	21.6	22.6	23.9	24.4	26.2	25.9	25.4	23.5	21.8
II.	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	4.0	3.7	3.7	4.0	9.0	6.9	6.2	5.1	5.1	4.8
1	Pushteti vendor (stok)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Borxhi publik i garantuar (stok)	4.0	3.7	3.7	4.0	3.8	4.2	5.0	5.0	5.0	4.7
	nga të cilat: për sistemin energjistik (fluks)						0.5	1.0	0.6	0.5	
	nga të cilat: të tjera përveç sistemit energjistik (fluks)						0.0	0.0	0.0	0.0	
5	Stoku i detyrimeve të papaguara (stok)					5.2	2.6	1.1	0.0	0.0	
PBB nominal		100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Ministria e Financave

**VENDIM****Nr. 70, datë 28.1.2015**

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR, TË PRONËS NR. 598, ME EMËRTIM “QENDËR MOBILIZIMI”, ME VENDNDODHJE NË GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, të pronës së paluajtshme shtetërore nr. 598, me emërtim “Qendër Mobilizimi”, me vendndodhje në Gjirokastrë, sipas formularit standard të

inventarizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së disa prej institucioneve të drejtësisë për ta përdorur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve dhe të gjykatave të apelit”, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RRETHI GJIROKASTER

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave si klasa te vecanta)

Bashkia Gjirokastrë										
A			B				C			
Nr	Zona Kadast Indeksi i hartës	Numeri Pasuris	Emërtesa e pronës Vendodhja/ shirirja Gjeografike	Komponentet perberes te pronës	Adresa/ vendodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne M2 ose MI	Funksioni per te cilin perdoret prona	Enti me Përgjegjësi Administrative	Enti Perdorues Statusi Jundik i perdorimit	Te dhena te tjera shenime te vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
598			Qendra Mobilizimit			1964 M2	Për Mbrojtjen	MM Q. Mobilizimi Gjirokastrë	Qendra Mobilizim Gjirokastrë	
			Lagja "11 Janari", Gjirokastrë	Godina e QM	Gjirokastrë	197				2 kate
				Truproje		4				
				Tuneli		10 mi				
				Trulli		1763				



PLAN RILEVIMI

PERGATITI

Emri: QEMO LANILicenca Nr T 0230/1 Date 18/12/2002
Data e pergatitjes: 26/04/2004

KUFIZIMET

VERIU: TR. 1 LIRELINDJE: 8/20, 8/19JUGU: TR. 1 LIREPERENDIMI: TR. 1 LIRE

SIPERFAQJA:

TOTALE: 1964.02E NDERTUAR: 201.00 M²


Vula / Firma

INDETIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8541NR. I PASURISE 8/23 VOL FQINDEKSI I HARTES G-8, G-9SHKALLA 1:500ADRESA E PASURISE: Rrethi GJIROKASTERQ/F GJIROKASTER Rr/LP/G Sh K Ap

PRONARI

QENDRA E RENDITJEVEGjiSHKoComel



**VENDIM****Nr. 72, datë 28.1.2015****PËR SHPALLJEN E ZONËS
EKONOMIKE, ME STATUSIN “ZONË E
LIRË”, NË SPITALLË, DURRËS, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 391, DATË 21.2.2008, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN
“ZONË EKONOMIKE”, NË SPITALLË,
DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Zonë e lirë”, të territorit, me sipërfaqe 500 (pesëqind) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numër pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtrirja dhe kufizimet e kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Lloji i veprimtarisë që do të zhvillohet në këtë zonë është:

- prodhuese, industriale dhe agropërpunim;
- tregtare dhe magazinim mallrash;
- shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 vjet.

5. Zona jepet me çmimin simbolik 1 euro.

6. Për procedurën e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës së lirë zbatohen rregullat dhe procedurat konkurruese të përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

7. Për pjesët e truallit të kësaj zone, që janë pronë private, të bëhet shpronësimi, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

8. Në vendimin nr. 391, datë 21.2.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Park industrial”, të territorit, me sipërfaqe 350 (treqind e pesëdhjetë) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numër pasurie, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

b) Lista bashkëlidhur dhe që përmendet në pikën 1 të vendimit, zëvendësohet me listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.


c) Harta bashkëlidhur dhe që përmendet në pikën 2 të vendimit, zëvendësohet me hartën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 16.3.2011, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës, tokë bujqësore, të ndodhur në ish-Ndërmarrjen Bujqësore, Spitallë, Durrës, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për ndërtimin e një kampusi të ri universitar”, dhe nr. 246, datë 12.4.2012, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien e statusit të zhvilluesit të një territori të zonës ekonomike Spitallë, Durrës, dhe miratimin e bonusit për shoqërinë”, shfuqizohen.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



-  Parcela Shtet S=4,867,883 (486.78 Ha)
-  Parcela Private S=4,715,474m2 (471.54 Ha)
-  Parcela Kanal, Rruge



LISTA E PASURIVE QË DO TË
PËRFSHIHEN NË “PARKUN INDUSTRIAL”

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurie	Lloji i pasurisë
1	8517	15	arë
2	8517	16	arë
3	8517	17	arë
4	8517	18	arë
5	8517	19	arë
6	8517	20	arë
7	8517	21	arë
8	8517	24	arë
9	8517	25	arë
10	8517	31	arë
11	8517	32	arë
12	8517	33	arë
13	8517	38	arë
14	8517	39	arë
15	8517	40	arë
16	8517	41	arë
17	8517	42	arë
18	8517	43	arë
19	8517	44	arë
20	8517	51	arë
21	8517	52	arë
22	8517	53	arë
23	8517	60	arë
24	8517	61	arë
25	8517	62	arë
26	8517	68	arë
27	8517	69	arë
28	8517	70	arë
29	8517	72	arë
30	8517	74	arë
31	8517	82	arë
32	8517	83	arë
33	8517	84	arë
34	8517	98	arë
35	8517	99	arë
36	8517	100	arë
37	8517	106	arë
38	8517	107	arë
39	8517	108	arë

LISTA E PASURIVE QË DO TË
PËRFSHIHEN NË “ZONË E LIRË”

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë
1	8,517	22	arë
2	8,517	23	arë
3	8,517	34	arë
4	8,517	35	arë
5	8,517	36	arë
6	8,517	37	arë
7	8,517	45	arë
8	8,517	46	arë
9	8,517	47	arë
10	8,517	48	arë
11	8,517	49	arë
12	8,517	50	arë
13	8,517	63	arë
14	8,517	64	arë

15	8,517	65	arë
16	8,517	66	arë
17	8,517	67	arë
18	8,517	76	arë
19	8,517	78	arë
20	8,517	79	arë
21	8,517	80	arë
22	8,517	81	arë
23	8,517	101	arë
24	8,517	102	arë
25	8,517	103	arë
26	8,517	104	arë
27	8,517	105	arë
28	8,517	147	vaskat

VENDIM

Nr. 73, datë 28.1.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË,
NDËRMJET MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS,
DHE SHOQËRISË “PRIMAVERA
INDUSTRY” SHPK, SI QIRAMARRËS,
PËR PASURINË “SALLË PRODHIMI NË
KATIN PËRDHES NË “PRODHIM
VESHJE” SHA, DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhenës, dhe shoqërisë “Primavera Industry” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Sallë prodhimi në katin përdhes në “Prodhim veshje” sh.a., Durrës”, me sipërfaqe të përgjithshme 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 74, datë 28.1.2015**

**PËR NDRYSHIMIN, NGA TOKË
BUJQËSORE “ARË” NË TOKË URBANE,
“TRUALL”, TË SIPËRFAQES PREJ 15 000
m², NË ZONAT KADASTRALE NR. 2119
DHE NR. 2105, KASHAR, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin, nga tokë bujqësore “arë” në tokë urbane, “truall”, të sipërfaqes prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) m², në zonat kadastrale nr. 2119 dhe nr. 2105, Kashar, Tiranë, sipas të dhënave në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, të qarkut Tiranë, të pasqyrojë, në dokumentacionin kadastral përkatës, ndryshimin e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore “arë” në tokë urbane, “truall”, për sipërfaqen prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) m², në zonat kadastrale nr. 2119 dhe nr. 2105, Kashar, Tiranë.

3. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të bëjë ndryshimin e llojit të pasurive, në certifikatat e pasurive, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****Sipërfaqja e pasurive arë është****15,000 m²**

Pasuritë i përkasin zonës kadastrale nr. 2105 dhe 2119 Tiranë

Nr.	Nr. pasurisë	Sipërfaqja (m ²)	Vol.	Faqe	Emër Mbiemër	Zëri kadastral
Komuna Kashar, Tiranë						
1	95/19	2,462	21	235	Amadeus Palace	arë
2	95/20	2,538	21	236	Besim Elshan	arë
3	95/21	1,971	21	237	Amadeus Palace	arë
4	95/22	3,029	21	234	Hysni Vasili	arë
5	95/23	5,000	11	189	Amadeus Palace	arë
6						
TOTALI TOKË ARË		15,000	m²	Tokë arë për t'u konvertuar në tokë urbane		

**VENDIM****Nr. 75, datë 28.1.2015****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 267, DATË 21.4.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS SË ALUIZNI-T ME ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE AGJENCINË E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËROR NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 5, të vendimit nr. 267, datë 21.4.2010, të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“Relacionet shpjeguese, së bashku me planet e rëlvimit, të depozituara pranë ZRPP-së, rishikohen nga ALUIZNI nëse evidentohen ndryshime në gjendjen faktike të njësive të ndërtuara. ALUIZNI depoziton relacionin dhe planin e rëlvimit, të rishikuara, për zonën me përparësi turizmin, në ZRPP-në përkatëse, duke zëvendësuar ato pararendëse.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 78, datë 28.1.2015****PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 150/2014, DATË 6.11.2014, “PËR PENSIONET E PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në

miniera, në nëntokë”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. PERIUDHA E SIGURIMIT NË PROCES PUNE NË MINIERA NË NËNTOKË DHE PERIUDHA E PËRGJITHSHME E SIGURIMIT**

1. Në zbatim të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

a) njihet si periudhë sigurimi në procese pune, në nëntokë, deri në datën 30.9.1993, çdo periudhë pune e kryer sipas kriterëve të përcaktuara në kreun I, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar;

b) njihet si periudhë sigurimi në procese pune, në nëntokë, pas datës 30.9.1993, çdo periudhë pune e kryer dhe e dokumentuar, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik në subjekte private apo me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror;

c) pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihet si periudhë sigurimi në procese pune, në nëntokë, puna e kryer dhe e dokumentuar në subjekte private apo me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror, vetëm kur janë derdhur kontributet shtesë, në masën 5% të pagës bruto, për efekt kontributi;

ç) për personat që, deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, përfitonin trajtimin e veçantë financiar sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar;

i) do të konsiderohet periudhë sigurimi në procese pune, në nëntokë, periudha që është njohur dhe miratuar, si periudhë pune në nëntokë, në vendimin e caktimit të trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë;

ii) do të konsiderohet periudhë sigurimi e vlerësuar me pagë minimale edhe e gjithë periudha nga data e fillimit të trajtimit të veçantë financiar deri në datën e fillimit të pensionit;

iii) paga neto për efekt të llogaritjes së masës fillestare të pensionit, kur e drejta për përfitim lind



deri në datën 31.12.2014, sipas periudhës së zgjedhur, do të jetë paga neto e tri viteve rresht në dhjetë vitet e fundit të punës, e indeksuar me indekset e përcaktuara nga Ministria e Financave, kur pagat përzgjidhen përpara datës 1.10.1993 dhe me vendime të Këshillit të Ministrave për periudhën pas datës 1.10.1993.

2. Të gjitha periudhat e njohura si periudha sigurimi në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të njihen si periudha sigurimi të përgjithshme për efekt të këtij ligji.

II. KONTRIBUTET DHE FINANCIMI I PËRFITIMEVE

1. Punonjësit, që kryejnë procese pune në miniera, në nëntokë, do të paguajnë kontributet e detyrueshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe kontributet shtesë, sipas nenit 6, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”. Kontributi shtesë do të llogaritet dhe do të paguhet në masën 5% të pagës bruto, brenda kufirit të pagës minimale dhe maksimale, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky kontribut shtesë do të paguhet në masën 3% nga punëdhënësi dhe 2% nga punëmarrësi.

2. Punëdhënësit e punonjësve, që kryejnë procese pune në miniera, në nëntokë, janë të detyruar të llogaritin dhe të derdhin kontributin shtesë në të njëjtën llogari dhe me të njëjtën procedurë, si për kontributin e detyrueshëm të sigurimit shoqëror. Evidentimi i procesit të punës në nëntokë do të bëhet në kolonën, “kontribut shtesë” në formatin e deklaratës së listëpagesës së miratuar.

3. Diferenca ndërmjet të ardhurave nga kontributet shtesë dhe shpenzimeve të programuara deri në plotësimin e moshës së daljes në pension, sipas përcaktimeve të neneve 31 dhe 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, do të financohet nga buxheti i shtetit sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Financave.

III. PROCEDURAT E CAKTIMIT TË PËRFITIMEVE

1. Në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, pensioni i pleqërisë për punonjësit që kryejnë procese pune në miniera, në nëntokë,

jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë së bashku me dokumentacionin përkatës, pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore ku ka vendbanimin.

Procedura e aplikimit, dokumentacioni i kërkuar si dhe procedura e caktimit, administrimit dhe pagesës së pensioneve përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Llogaritja e pensioneve të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë, në zbatim të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, bëhet nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ku minatori ka qendrën e tij të banimit.

3. Pensioni llogaritet sipas përcaktimeve në nenet 32 e 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, në varësi të momentit kur subjekteve përfituese u lind e drejta për përfitim të pensionit sipas ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

4. Personave, që plotësojnë kushtet për përfitim sipas përcaktimeve të këtij ligji, deri në datën 31.12.2014, pensioni do t’u llogaritet sipas dispozitave ligjore në fuqi deri në këtë datë. Masës së pensionit të llogaritur do t’i shtohen dhe kompensimet e të ardhurave sipas masës dhe kritereve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”.

5. Nëse e drejta për përfitim, sipas nenit 3, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, u ka lindur ish-punonjësve të nëntokës, që përfitonin trajtimin e veçantë në përputhje me ligjin nr. 8685, datë 9.11.2000, të ndryshuar, deri në datën 31.12.2014, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Kur kërkesa për pension është paraqitur brenda vitit nga data e lindjes të së drejtës, por deri në atë moment kanë tërhequr trajtimin e veçantë financiar, pensioni do të caktohet sipas neneve 32 e 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, në fuqi deri më



31.12.2014, me datë fillimi nga data e lindjes të së drejtës dhe do të paguhet diferenca mes pensionit të pleqërisë dhe trajtimit të veçantë financiar si punonjës i nëntokës;

b) Kur kërkesa për pension është paraqitur pasi ka kaluar një vit nga data e lindjes të së drejtës, por deri në atë moment kanë tërhequr trajtimin e veçantë financiar, pensioni do të caktohet sipas neneve 32 e 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, në fuqi deri më 31.12.2014, me datë fillimi pagese nga data e paraqitjes së kërkesës dhe do të paguhet vetëm diferenca mes pensionit të pleqërisë dhe trajtimit të veçantë financiar si punonjës i nëntokës, nga data e paraqitjes së kërkesës.

6. Për rastet kur subjekteve përfituese të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, të cilat përfitonin trajtimin e veçantë sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, u lind e drejta për përfitim pas datës 31.12.2014, pensioni do të caktohet sipas neneve 32 e 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.7.2014.

Përfitimet sipas ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, do të jenë objekt auditimi nga organet përkatëse audituese të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në përputhje me rregulloren përkatëse.

IV. EFEKTET FINANCIARE

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të cilat llogariten në shumën 793 milionë lekë për pensione dhe shpenzime të tjera administrative, të përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i programuar për vitin 2015.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e rregullores përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, për pensionet, ndërsa për kontributet, efektet financiare fillojnë nga data 1.1.2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 79, datë 28.1.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I AMFITEATRIT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i Amfiteatrit të Durrësit”, miratuar me vendimin nr. 112/2014, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi për pasurinë trull dhe ndërtim, me një vlerë të përgjithshme ndërtimi prej 21 660 027 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 21 660 027 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Kulturës.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 31.1.2015.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Kulturës.

7. Shpenzimet për botimet publike në gazeta të përballohen nga fondet e aparatit të Ministrisë së Kulturës, zëri “602”.

8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “sipas kartelës së pasurisë”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë



pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK, TË CILAT PREKEN NGA "PROJEKTI PËR REHABILITIMIN E HAPËSIRËS SË AMFITEATRIT TË DËRRËSIT"

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe (m ²)		Çmimi Lekë/m ²		Vlera lekë			SHËNIME
				truall	ndërtim	truall	ndërtim	truallit	ndërtese	banesë	
1	Ahmet Dragovoja	8512	24/15	156.0	236.5	17,898	70,093	2,792,088		16,576,994.50	sipas kartelës së pasurisë
3	Jonuz Myshketa	8512	24/173	128.0	0.0	17,898	70,093	2,290,944		-	sipas kartelës së pasurisë
				284	236.5			5,083,032		16,576,995	21,660,027
TOTALI:				21,660,027 LEKË							

VENDIM

Nr. 81, datë 28.1.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 241, DATË 31.3.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRYERJEN, NGA "POSTA SHQIPTARE" SHA, TË SHËRBIMEVE POSTARE, FINANCIARE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA, QË JANË NË PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E KËSAJ POSTE, PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE E VENDORE, INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE SI DHE SHOQËRITË TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 7, të ligjit nr. 8530, datë 23.9.1999, "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në titull dhe në pikën 1, të vendimit nr. 241, datë 31.3.2011, të Këshillit të Ministrave, hiqen fjalët " ... si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror..."

2. Ngarkohet ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 82, datë 28.1.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION DHE ZGJERIM I
RRUGËS “DON GJON BUZUKU”,
KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës “Don Gjon Buzuku”, Korçë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truall, banesë dhe ndërtesë, me një vlerë të përgjithshme prej 88 587 210 (tetëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 88 587 210 (tetëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dhjetë) lekësh të përballohet nga subjekti kërkues, Bashkia Korçë,

kurse shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 5.2.2015.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Korçë.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



TABELA E DETAJUAR E VLERËS SË SHPRONËSIMIT PËR PROJEKTIN “RIKONSTRUKSION DHE ZGJERIM I RRUGËS “DON GJON BUZUKU” KORÇË

Nr.	Nr. pasurie	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i pasurisë	Sip. truall total sipas ZVRPP m ²	Vlera truall lekë/m ²	Nr. kateve	Sip. banesë totale nd. (m ²)	Vlera banesa lekë/m ²	Sip. njësi shërbim (m ²)	Sip. trualli pjesshëm (m ²)	Vlera e truallit total (lekë)	Vlera e banesës (lekë)	Vlera e njësisë shërbim (lekë)	Sip. trualli nën ndërtesë (m ²)	Sip. trualli jashtë ndërtesës (m ²)	Vlera e truallit jashtë ndërtesës (lekë)	Totali shpronësim (lekë)
1	5/347	Rita Ali Koça, Spiro Hekuran Koça	T+Nd	79.6	7,535	2.5	137	45,230			—	6,196,510		54.8	24.8	186,868	6,383,378
2	5/598	Natasha Alit Strati(Zesllati)	T+Nd	99	7,535	2	117.6	45,230			—	5,319,048		58.8	40.2	302,907	5,621,955
3	5/876	Agim Beshir Bardhi + bpr	T+Nd	70.5	7,535	1	38.5	45,230			—	1,741,355		38.5	32.0	241,120	1,982,475
4	5/824	Bajram Faslli Tako	Nd		7,535	1	45	45,230			—	2,035,350		45.0	0.0	0	2,035,350
5	5/130	Arben Feta	T+Nd	131	7,535	2	171	45,230			—	7,734,330		85.5	45.5	342,843	8,077,173
6	5/558	Jorgo Stefa	T+Nd	114	7,535	1	78.08	45,230			—	3,531,558		78.1	35.9	270,657	3,802,216
7	5/859	Agim Hajdar Tefik	T+Nd	114	7,535	3	152.22	45,230			—	6,884,911		50.7	63.3	476,664	7,361,575
8	5/177	Hydri Sabri Kape	T+Nd	135.3	7,535	2	183.2	45,230			—	8,286,136		91.6	43.7	329,280	8,615,416
9	5/175	Gurije Rakollari +bpr	T+Nd	134.4	7,535	1	31.9	45,230			—	1,442,837		31.9	102.5	772,338	2,215,175
10	5/426	Petrit Musa Xhelollari	T+Nd	137.8	7,535	3	247	45,230	74		1,038,323	11,171,810	2,154,342	108.0	29.8	224,543	14,364,475
11	5/440	Zamir Islam Topi	T+nd	59	7,535			—	59.01		444,565	0	2,135,018	59.0	0.0	0	2,579,583
12	5/458	Robert Çarçani	T+Nd	90	7,535	1		—	70		678,150	0	2,145,487	70.0	20.0	150,700	2,823,637
13	5/352	Serdil Manka ,Musa Manka	T+Nd	170.7	7,535	2	150.6	45,230		117.5	—	6,811,638		59.5	58.0	437,030	7,248,668
14	5/131	Ari Fuat Maliq	T+Nd	135.2	7,535		—	—		58	437,030			0.0	58.0	437,030	437,030
15	5/348	Zini Besim Berberi	T	441.4	7,535		—	—		106	798,710				106.0	798,710	798,710
16	5/353	Ali Afiz Goçllari	T	184.2	7,535		—	—		45	339,075			0.0	45.0	339,075	339,075
17	5/556	Gjylizar Kogibelli	T	120.8	7,535		—	—		12	90,420			0.0	12.0	90,420	90,420
18	5/829	Kristal Shyti	T	66.2	7,535		—	—			498,817					498,817	498,817
19	5/537	Salie Shishmani	T	151.2	7,535		—	—			1,139,292					1,139,292	1,139,292
20	5/538	Hektor Frashëri	T	66.6	7,535		—	—			501,831					501,831	501,831
21	5/441	Altin Ismail Topi+bpr	T	118.1	7,535		—	—			889,884					889,884	889,884
22	5/452	Edmond Haxhi Zake	T	202	7,535		—	—			1,522,070					1,522,070	1,522,070
23	5/439	Mukadez Riza Topi	T	177	7,535		—	—			1,333,695					1,333,695	1,333,695
24	5/472	Feride Teki Moskopoli	T	77.3	7,535		—	—			582,456					582,456	582,456
25	5/475	Isa Tefik Gegollari	T	78	7,535		—	—			587,730					587,730	587,730
26	5/448	Ali Qeraxhi + bpr	T	750	7,535		—	—			5,651,250				750.00	5,651,250	5,651,250
27	5/900	Riza Zeni Lika + bpr	T	69.5	7,535		—	—			523,683					523,683	523,683
28	5/964	Vladimir Agolli + bpr	T	77	7,535		—	—			580,195					580,195	580,195
TOTALI																	88,587,210

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006